

VENDIM
Nr. 172, datë 7.11.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“ENERGIA GAS AND POWER” SHPK, NR. 258, SERIA T14, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 133, DATË 24.12.2014**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; si dhe neneve 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15, të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 101/5 prot., datë 31.10.2019, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes lidhur me “Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Energia Gas and Power’ sh.p.k, me nr. 258, seria T14, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k, është mbajtëse e licencës me nr. 258, seria T14, në veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014, me afat 5-vjeçar, e cila përfundon në datën 24.12.2019.

- Shoqëria “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 461/1 prot., datë 9.10.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuar nga ERE-ja në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- Format i aplikimit (nenit 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentet juridike, administrative dhe pronësore (nenit 9, pika 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) janë plotësuar pjesërisht;

- Dokumentet financiare dhe fiskale (nenit 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) janë plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, (neni 9, pika 4.8, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionin e munguar apo të paplotësuar e që lidhet me:

- Neni 9, pika 2, gjerat: “a”, “b” (akti i themelimit/statuti) nuk është depozituar një kopje e këtyre dokumenteve;

- Neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë) janë depozituar pjesërisht.

Do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto dokumente në ERE, brenda afateve të përcaktuara në nenin 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power” sh.p.k, nr. 258, seria T14, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes së Tregut do të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti